# DËSHMI ARKIVI

**A-441338**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pas SPAR-it, hajduti i vajit Xhevdet Rexhepi ble edhe Eco Market nga vëllezërit Duka, krijon monopol në Shqipëri, Denar Biba vulos kapjen e tregut të ushqimeve |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/07/pas-spar-it-hajduti-i-vajit-xhevdet-rexhepi-ble-edhe-eco-market-nga-vellezerit-duka-krijon-monopol-ne-shqiperi-denar-biba-vulos-kapjen-e-tregut-te-ushqimeve/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:43:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 09:05:18 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a18898020bee43af03c9dc043fa2f00b2ed86198421c39024dc805ae6a7e96ce` |
| TEKSTI | `9daf889053dc0e5d23af11f7b3dc799e49f858fa97024d1cf95b070d6208e8d1` |
| PAMJA | `c5e0cb3a499ff446ba113b1ac22c535bd2d44de81bf8ba1d74dfeec7acfc66d4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `50b68ebdff094cb3afe746f7f499698fd05c2124d632d06a0b975e4a7510c81b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/50b68ebdff094cb3afe746f7f499698fd05c2124d632d06a0b975e4a7510c81b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Pas SPAR-it, hajduti i vajit Xhevdet Rexhepi ble edhe Eco Market nga vëllezërit Duka, krijon monopol në Shqipëri, Denar Biba vulos kapjen e tregut të ushqimeve

Investigim

Publikuar: 07/09/2026




Pas blerjes së rrjeti SPAR nga grupi Balfin një vit më parë, biznesmeni kosovar Xhevdet Rexhepi, i skeduar për skema mashtrimi dhe zhvatje masive sidomos përmes shitjes së vajit duke shfrytëzuar pozitat monipoliste, ka blerë një tjetër rrjet të madh marketesh në Shqipëri, duke krijuar një monopol në tregun e shitjes së ushqimeve me pakicë. Këtë herë bëhet fjalë për zinxhirin e supermarketeve Eco Market, që zotëroheshin nga Armand dhe Agron Duka.



***Agron dhe Armand Duka***

Shifra e transaksionit nuk është bërë publike, por marrëveshja mes palëve është mbyllur siç njoftoi Autoriteti i Konkurrencës, i cili ka dhënë dhe miratimin për këtë transaksion. Ka dyshime të forta se rrufjani Xhevdet Rexhepi ka kompromentuar përmes interesave të paligjshme kreun e Autoritetit të Konkurrencës,

Me te lexuarat


Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Spahi...


Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administrat...


I tmerrshmi i Beratit / Si ra Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik kokaine, saga e ...


Porolli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izrae...


Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

duke miratuar kapjen e tregut të shitjes së ushqimeve.

Rrjeti i marketeve “Eco Market” përfshin 16 markete të vendosura në Tiranë, Durrës dhe Fier. Aksionet e tij mbaheshin nën shoqërinë D & D Distribution, aksionet e së cilës zotërohen gjysmë për gjysmë nga Armand dhe Agron Duka. Vitin e kaluar kjo shoqëri realizoi një xhiro prej 25 milionë eurosh dhe rezultoi me humbje fiskale në masën 300 mijë euro.

Ky është rrjeti i dytë i marketeve që biznesmeni kosovar Xhevdet Rexhepi ble në Shqipëri. Vitin e kaluar ai bleu rrjetin e dytë më të madh të marketeve në vend, zinxhirin SPAR nga grupi Balfin për rreth 44 milionë euro.




***Xhevdet Rexhepi***

Përmes blerjes së Eco Market, Rexhepi zgjeron edhe më shumë peshën e tij në tregun e shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe të konsumit të përditshëm në Shqipëri duke u bërë tashmë lojtari më i madh në këtë treg. Rexhepi është akuzuar nga autoritetet kosovare për zhvatjen përmes mashtrimit të blerëve me çmimet e vajit në rrjetet e super marketeve “Viva Fresh Store” dhe “Super Viva”.

Në vitin 2022, Xhevdet Rexhepi çoi në ekstrem çmimin e një litër

vaji, 3 euro e 49 cent është, në super-marketet e tij në Kosovë. Përveç këtij çmimi ekstrem, rrjeti i marketeve të njohura "Viva Fresh Store" në raftet e vajit kishte vënë edhe banderola ku shkruhej se sasia e mbetur e vajit ishte e limituar, ndërkohë që në rafte gjithashtu ishin lënë pak paketime të ekspozuara, për të bindur blerësit se mbishkrimi në banderola ishte i vërtetë.

Por gjithçka rezultoi një skemë zhvatje. Krimi Ekonomik i Policisë së Kosovës dhe Inspektorati i Tregut, pasi bastisën depon kryesore të "Viva Fresh Store" në dalje të Prishtinës, gjeten mijëra litra vaj të fshehur në depo. Pas operacionit policor, çmimi i vajit ra në 2 euro. Nga kjo skemë Xhevdet Rexhepi u zhvati familjeve kosovare miliona euro.

Evidenca dhe fakte tregojnë se Xhevdet Rexhepi ka zbaruar skema të tjera mashtrimit në Kosovë, me qëllim zhavtje, ndërsa aktivitetin kriminal po e shtrin edhe në Shqipëri. Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut ka gjobitur me 1 mijë e 500 euro kompaninë Viva Fresh Sh.P.K të Xhevdet Rexhepit për shitje në arkë të produktit me çmim më të lartë se sa çmimi që ishte vendosur në raft.

TAG: Afera | Cmimi i vajit | Eco market | Mashtrim | Monopol | SPAR | Viva Fresh | Xhevdet rexhepi

## Të ngjashme



**Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj**



**Pacolli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izraelit Ron Yeffet**



**Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administratë të djalit të kryebashkiakut të Shkodrës, si i pa...**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike,

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT


mediave te njesuara me interesat
klienteliste, krimit dhe biznesit jo të
ndershëm, të cilët në bashkëpunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.